

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues, e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Shaqë Curri, si procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarit A.M, për shkak të veprës penale, Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste, nga neni 143 par.2 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit A. Mj, av.J.Ç, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.100/2015, të dt.06.10.2015, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me datën 18.04.2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.M, av. J.Ç, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.100/2015, të dt.06.10.2015, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.100/2015,të dt.06.10.2015, i akuzuari A.M, është shpallur fajtor për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste, nga neni 143 par.2 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve, dhe dënimi plotësues ku i janë konfiskuar, pasaporta në emër të akuzuarit A.M, telefoni i markës "HUAËEI" me nr. imei 86429802545300, kartela e telefonit IPKO, me nr. serik 103012471726

I akuzuari është obliguar që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së kësaj gjykate në shumë prej 50(pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat kanë paraqitur ankesë:

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av. J.Ç, për shkak të vërtetimit jo të plot të gjendjes faktike, dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim se Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta kthej në rigjykim dhe vendim ose të njëjtin aktgjykim ta ndryshoj ose të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.124/2016, të datës 07.03.2016, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av.J.Ç, ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë i akuzuari A.M, mbrojtësi i tij av.J.Ç, ndërsa nuk morën pjesë Prokurori i Apelit-DKR

në Prishtinë, edhe pse ishin njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca e kolegjit është mbajtur në mungesë të tyre, për arsye se pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit i të akuzuarit av.J.Ç, edhe sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin me shkrim të Prokurorit të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, e pas shqyrtimit dhe vlerësimit edhe shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit i të akuzuarit A.M, av.J.Ç, është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e saj.

Ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av.J.Ç, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk e ka shqyrtuar e kjo për arsye se sipas dispozitës së nenit 383 par.2 për shkak se ankesa nuk mund të ushtrohet për bazën ankimore të cekur më lartë kur i akuzuari e pranon fajësinë e për të cilën trupi gjykues është pajtuar me pranimin e tillë.

Ankesa pretendon se është shkelë ligji penal, nga neni 385 par.1 nën par. 1.3, se i akuzuari nuk ka pasur njohuri se është duke vepruar në një grup terrorist gjatë shkuarjes në Siri në shtator të vitit 2013, dhe qëndrimin të tij një mujor gjer me dt.27.10.2013, dhe nuk kishte ditur se grupi "Jahbat Al Nustra", është shpallur grup terrorist.

Pretendimi i këfillë sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke vlerësuar pretendimin e cekur më lartë e edhe sipas detyrës zyrtare , kolegji penal vlerëson se pretendimi i tillë ankimor është i pabazuar, kjo për arsye se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajësinë dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe nuk është shkelë, ligji penal në dëm të akuzuarit dhe gjykata drejt ka vërtetuar se i akuzuari ka marr pjesë dhe i është bashkangjitur grupit terrorist në Siri të quajtur "Jahbat Al Nustra", prej dt.04.09.2013 e gjer me dt. 27.10.2013, e kjo për arsye se me marrjen pjesë në veprimtarin e grupit terrorist "Jahbat Al Nustra", i cili grup vepron për kryerjen e veprave penale të terrorizmit, e të cilës i është bashkangjitur edhe i akuzuari A.M, e nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar ligjin penal të paraparë si në nenin 385 par.1 të KPP.

Gjykata e Apelit në bazë të nenit 396 të KPP, sipas detyrës zyrtare edhe pse aktgjykimi nuk është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me dënimin, aktgjykimi është vlerësuar edhe në këtë drejtim, për arsye se aktgjykimi është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal. Gjykata e shkallës së parë gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese mbi rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit të parapara si në nenin 73 të KPRK, ku si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen korrekte të akuzuarit, pranimin e fajësisë dhe pendimin dhe premtimin e thellë të tij se nuk do përsëris veprën penale, sjelljet e të akuzuarit , e të cilat rrethana si të vërtetuara i merr edhe Gjykata e Apelit.

Gjykata e Apelit vlerëson se, edhe pse gjykata e shkallës së parë, ia ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)vite, i cili dënim i shqiptuar është nën minimumin e paraparë

ligjorë, dënimi i këtillë i shqiptuar është në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 75 par.1.3, të KPRK, kjo për arsye se gjykata me rastin e pranimit të fajësisë sa i përket zbutjes së dënimit gjykata, nuk detyrohet nga kufizimet e parapara si në nenin 76 e që ka të bëjë me kufijtë e zbutjes së dënimeve e i cili dënimi shqiptuar është nën minimumin e paraparë ligjorë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dënimi i këtillë i shqiptuar do të shërbej preventives individuale që i akuzuari në të ardhmen mos të përsëris vepra penale të këtilla apo tjera, si dhe preventivës së përgjithshme që dënimi i këtillë të ndikoj edhe tek të tjerët në parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, dhe pritët në tersi të arrihet edhe qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK .

Si u cek edhe më lartë u desh që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit av.J.Ç ,të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, në bazë të nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.132/2016, me dt.18.04.2016

Procesmbajtësi,

Shaqë Curri

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit,

Vahid Halili